

Kërkesat për hapjen e kutive të votimit vazhdojnë të jenë tema e ditës në deklaratat e opozitës. Nga e tij, kryeministri Berisha i cili ditën dhe natën (më shumë natën se ditën) do përpiqet prej shumë muajsh të gjejë një zgjidhje të përbashkët për çështjen e kutive.

Opozita do që të hapen kutitë, por edhe kryeministri do që të hapen. Por ja që [ligjet e Kushtetutës](#) nuk e lejojnë drejt ta hajë.

Kryeministri Berisha udhëtoi në [trecerekun e shteteve të botës, në kërkim të zgjidhjes](#), ndodhi mrekullia. Sepse zgjidhja vonoi por nuk harroi.

Pas 200 vjetësh kërkesa të parreshtura nga ana e opozitës, shteti grek ka vendosur të hapë kutitë e arkivave të [Sali Pasha Kamzalenës](#). Për herë tëparë pas kaq kohësh, Greqia jep shembullin më të qartë të transparencës, të bashkëpunimit dhe të integritit. Në këto kuti gjenden edhe fletët e votimit të zgjedhjeve të vitit 1822 për pashallakën e Tepelenës ku fitoi mazhoranca e kryesuar nga koalicioni i Sultanit.

KeshilliMinistrave.org



Pas këtij vendimit të qeverisë greke, kryeministri Berisha ka thirrur në një mbledhje urrgjente [Këshillin e Ministrave.org](#) duke e hapur seancën me fjalët “Do hap kutitë”.

Këto fjalë të papritura shkaktuan që [2/3 e ministrave](#) tu binte të fikët. Menjëherë ministrat e tjerë që u mbajtën si burrat u dhanë ndihmën e parë kolegëve të rëzuar nga karriket duke i freskuar me ujë qeverie dhe duke kënduar në kor himnin “Shqipëria po ndryshon”.

Pasi u qetësua e gjithë [skuadra qeveritare](#) , kryeministri Berisha vazhdoi fjalën duke sqaruar ministrat e shkretë se sapo të mbusheshin 200 vite nga dita e sotme do të plotësonte menjëherë dëshirën e opozitës për kutitë.

“Nëse këtë gjë e ka bërë një shtet anëtar i Bashkimit Europian, anëtar i NATO-s, atëherë nuk shoh arsye për të mos vepruar edhe ne si ajo. E di, që pata premtuar se nuk do ti hapja kutitë edhe sikur të ngrihej mësuesi im Enver Hoxha nga varri, por unë i bindem zërit të Europës” deklaroi Berisha duke deklaruar se në seancën e radhës të kuvendit do ti propozonte opozitës hapjen e kutive diku nga Korriku i vitit 2210.